

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                       |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Musa: S'është koha për zhbërjen e Speciales, por që ajo t'i jap përgjegjësi Kosovës                                                                                                                                                   |
| ADRESA  | <a href="https://www.koha.net/arberi/musa-seshte-koha-per-zhberjen-e-speciales-por-qe-ajo-ti-jap-pergjegjesi-kosoves">https://www.koha.net/arberi/musa-seshte-koha-per-zhberjen-e-speciales-por-qe-ajo-ti-jap-pergjegjesi-kosoves</a> |
| BURIMI  | koha.net                                                                                                                                                                                                                              |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 21 shtator 2026, 04:09:18 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 20 shtator 2026, 07:48:23 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 99e8e8241d5f1ceaa9faf83939ab8921e9903127e57c94c399739ad48c43c331 |
| TEKSTI     | 20ac0f30a5168a90937512513e8650e5ac9e7a50ad63e129089190ef2ff65880 |
| PAMJA      | 6c403df3e0f16971716ee84f6addfa65f7bb24f511f8dd081f555ade873c0108 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 05aa4a5859adaea0b5b9e01cf7bee3d4f9f528016414ccffe90c5ed1cc4acdf3                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | c0d9bd92529e02e16d47faaeabf511120c8d07d3ab9ecb9de413d471457ceb15                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/05aa4a5859adaea0b5b9e01cf7bee3d4f9f528016414ccffe90c5ed1cc4acdf3>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

ARBËRI

## Musa: S'është koha për zhbërjen e Speciales, por që ajo t'i jap përgjegjësi Kosovës



20 shtator 2026 09:48

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së, avokati Skender Musa ka thënë se aktualisht nuk është koha për zhbërjen e saj, por kërkon ndryshimin e mënyrës së funksionimit dhe rritjen e përgjegjësisë institucionale.

Musa ka kritikuar mënyrën se si ka vepruar Specialja, duke thënë se ajo duhet të japë llogari ndaj Kosovës dhe se duhet të ketë një koordinim institucional me sistemin e drejtësisë tonë.

"Në radhë të parë dua ta bëj të qartë mendimin tim: Kjo gjykatë i ka shërbyer Serbisë dhe vazhdon t'i shërbejë Serbisë. Nëse një gjykatë e tillë i shërben Serbisë atëherë nuk ka nevojë ta përdorë logon dhe t'i zbatojë ligjet e Kosovës. Nuk mendoj se është koha dhe momenti të punohet për zhbërjen e gjykatës, mirëpo është koha dhe momenti që kjo gjykatë t'i japë llogari Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe prokurori special t'i japë përgjegjësi Këshillit Prokurorial të Kosovës. Nuk mund të thirren në një pavarësi të gjykatës dhe një gjykatë komplet e pavarur dhe të bëjë kaq dëme të mëdha Kosovës, duke marrë udhëzime nga prokurorë dhe gjyqtarë dhe politikanë të Serbisë siç ka vepruar kjo gjykatë", ka thënë Musa në një intervistë për Ekonomia Online.

Avokati ka deklaruar se mënyra e deritanishme e punës së kësaj gjykate e bën atë një rast të veçantë në Evropë sa i përket rezultateve të proceseve ndaj të akuzuarve shqiptarë.

"E thashë edhe më herët, është e vetmja gjykatë që njihet në Evropë që të gjithë të akuzuarit i ka dënua dhe që pritet të dënohet çdo i akuzuar shqiptar që shkon para saj. Sepse vetëm shikojini ecurinë e punës së saj. Kjo gjykatë ka bashkëpunuar me prokurorë dhe policë serbë, hetues, ka marrë njerëz të sigurimit. Ata vetë kanë dalë publikisht dhe kanë thënë që 'Ne i kemi shkruar edhe aktakuzat, kallëzimet penale, i kemi intervistuar, kemi intervistuar dëshmitarët shqiptarë'", u shpreh Musa.

Musa ka kritikuar mungesën e bashkëpunimit të Speciales, me institucionet e drejtësisë së Kosovës.

"Nuk ka asnjë bashkëpunim me Policinë e Kosovës, me

### Showbiz.

Werner Herzog parashikon gjëra të mëdha për Orlando Bloom

### Lifestyle.

Cilat simptoma sëmundjesh nuk duhet t'i injoroni?

### Showbiz.

Gwyneth Paltrow tregon për vështirësitë pas ndarjes me Chris Martin

### Futboll.

Parisi fiton derbin ndaj Marseillet

### Futboll.

Fitore bindëse e Milanit

### Botë.

Merz e quan "katastrofë" rezultatit e CDU-së, por premtan se do të qëndrojë në detyrë

Prokurorinë e Kosovës dhe me asnjë hallkë të sistemit të drejtësisë. Duhet të ndryshohet mënyra e veprimit të kësaj gjykate. Kjo gjykatë duhet me i pasë qartë dhe institucionet duhet me ia bërë qartë që është gjykatë e Kosovës dhe që nuk guxon të ketë takime as kryetarja e gjykatës të Kosovës e as kryeprokurori i gjykatës të Kosovës me ministrin e punëve të brendshme, me ministrin e drejtësisë, me kryeprokuror apo me hetues të Serbisë”, ka thënë Musa.

Edhe



Arbëri • 18 sht 2026  
Mishetiq – Kosit: Nuk të takon ta paragjykosësh çështjen ndaj Thaçit

Musa ka kërkuar ndryshime në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe një rol më të madh të institucioneve të sistemit të drejtësisë së Kosovës në mbikëqyrjen dhe koordinimin institucional me Specialen.

“Duhet të ndryshohet ligji për Dhomat e Specializuara, duhet të jetë Këshilli Gjyqësor ai që duhet të kërkojë raport nga kjo gjykatë dhe të kujdeset për zbatimin e ligjit dhe vërtetimin e saktë të fakteve dhe provave, dhe duhet të jetë Këshilli Prokurorial dhe Kryeprokurori i Kosovës ata që duhet të mbajnë koordinimin dhe hierarkinë institucionale edhe me prokurorët specialë sepse ligji dhe Kushtetuta e parashohin si gjykatë të Kosovës”, shton ai.

Gjykata Speciale i ka dënua me 81 vjet burgim në total 4 ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është dënua me 25 vjet burgim. Jakup Krasniqi u dënua me 25 vjet burgim, Kadri Veseli me 18 vjet ndërsa Rexhep Selimi me 13 vjet burgim.

#SKENDER MUSA

#GJYKATA SPECIALE

#ISH-KRERËT E UÇK-SË

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 16 sht 2026  
Hoxhaj: E tërë klasa udhëheqëse të bëhet bashkë, Serbia do ta përdorë vendimin e Speciales



Arbëri • 2 kor 2026  
Musa: Mbi 29 mijë faqe materiale mund ta vonojnë edhe më tej aktgjykimin në Hagë



Arbëri • 6 maj 2026  
Musa: Prokurorët e gjyqtarët në Hagë s’do të guxonin t’i bënin këto shkelje në vendet e tyre



Arbëri • 3 tet 2025  
Rubin: Gjyqtarët e Speciales ishin të anshëm, dukej sikur tashmë kishin vendosur kundër Thaçit

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbejnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.